

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**TRANSKRIPT
NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 6 MARS 2003**

**TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 06. 03. 2003. GOD.**

**MARS - MART
2003**



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Ekspozeu i Kryeministrit për punën njëvjeqare të Qeverisë së Kosovës
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Likuidimin dhe organizimin e Personave juridik në bankrotim / 2003/2
5. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pjetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashresa të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 21.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВНИ РЕД

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
3. Експозе Премијера о једногодишњем раду Владе Косова
4. Друго разматрање Нацрта закона о Ликвидацију и Реорганизацију Правних Лица у Банкротству
5. Постављање питања

Опомена : *Питања упућена Влади за усмене одговоре*

Sekretariati i Shërbimeve të Kuvendit - Ndërtesa e Kuvendit / Ndërtesa e Qeverisë - Rruga Nënë Tereze - Kosovë / Posta e UNMIK-ut
Секретаријат скупштинских служби - Скупштина Косова / зграда Владе - улица Мајке Терезе - Косово / Пошта УНМИК-а
Assembly Services Secretariat - Assembly of Kosovo / Government Building - Mother Theresa Street - Kosovo / UNMIK Post

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

“Питања која захтевају усмени одговор морају да буду достављена у пријемну канцеларију барем пет радних дана, али не више од десет радних дана пре него што се очекује одговор”
(Правило 21.2 са Привремени пословник)

AGENDA

1. Agenda agreed
2. Minutes of previous meeting
3. Statement by the Premier for one year work of Government of Kosovo, and debate
4. Second reading of Draft Law on Liquidation and Reorganizing off Legal Persons in Bankruptcy
5. Questions

Note: *Questions to the Government for oral answer*

“Questions for oral answer shall be submitted to the Table Office at least five working days but not more than ten working days before they are to be answered” (Rule 21.2 of Provisional rules of procedure)

TRANSKRIPT
NGA SEANCA E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 6 MARS 2003

Seanca filloi punën në orën 10,00.

SEANCËN E KRYESOI, AKADEMIK NEXHAT DACI, KRYETAR I KUVENDIT TË KOSOVËS.

BASHKËKRYESUES, XHAVIT HALITI, ANËTAR I KRYESISË SË KUVENDIT.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes, deputetë të nderuar.

Mirë se keni ardhur në seancën e rregullt të radhës plenare.

Besoj se me kohë keni marrë materialet dhe rendin e ditës të kësaj seance dhe, siç e dini, pikë e parë e rendit të ditës është – Miratimi i rendit të ditës.

Besoj se mund të aprovohet rendi i ditës?

E ka fjalën zoti Ismajl Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

Zoti kryetar, zoti kryeministër dhe deputetë të nderuar,

Pasi që mes dy seancave në Kosovë është ngritur një çështje me rëndësi të veçantë – çështja e bisedimeve të palës kosovare me palën serbe, propozoj që në këtë seancë, si pikë urgjente, të futet çështja e bisedimeve dhe Parlamenti të marrë qëndrim për këtë çështje.

Me këtë rast dëshiroj të them se, edhe një herë, ju zoti kryetar, keni nënshkruar një dokument pa marrëveshje me Parlamentin. Prandaj, konsideroj se ky është tejkalim i kompetencave. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

E ka fjalën zoti Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Të nderuar deputetë,

Sot jemi në një ditë që, për popullin shqiptar të Kosovës konsiderohet ditë e shenjt, ditë e dëshmorëve, ditë e rënies së Komandantit Legjendar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Adem Jashari, ditë e epopesë së UÇK, për të cilën ne si Kuvend i Kosovës, nuk kemi kryer obligimin si qytetarë dhe karshi kërkesave të qytetarëve për njohjen e luftës çlirimtare që ka bërë populli ynë për liri dhe pavarësi.

Grupi ynë Parlamentar, siç ju kemi njofuar, ka bërë një Projektrezolutë, me anë të së cilës vlerat për liri dhe pavarësi të popullit të Kosovës, posaçërisht vlerat çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të mbrohen me ligj duke u konsideruar këto vlera si vlera të drejta dhe çlirimtare dhe lufta jonë duke u konsideruar si luftë e drejtë dhe luftë çlirimtare.

Prandaj, duke parë se Kryesia ka bërë një shkelje të procedurës në punën e Kuvendit, të rregullës 19, pika 3 dhe 4, që ka përcaktuar këtë rend të ditës për këtë seancë, pa konsultimin paraprak të grupeve parlamentare dhe pa konsultimin e shefave të grupeve siç parashihet me pikën 3 të Rregullës 19 të Rregullores së punës të Kuvendit, ne konsiderojmë që nuk mund të vazhdohet në këso forme dhe kërkoi që grupet parlamentare, konkretisht shefat e grupeve të pajtohen se Rezoluta apo Projektrezoluta e paraqitur nga Grupi Parlamentar i Aleancës të hyjë në procedurë të rendit të ditës.

Mungesa e Grupit Parlamentar të Aleancës në seancë është për këtë arsy. Në rast se hyn, ne mund t'i harmonizojmë qëndrimet si grupe parlamentare dhe të bëjmë një dokument apo të përcaktohem për një ligj për njohjen e këtyre vlerave. Në rast se s'hyn, ne nuk do të marrim pjesë në këtë seancë. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Urdhëroni, zoti Bajrush Xhemajli.

BAJRUSH XHEMAJLI:

E nderuar Kryesi, të nderuar deputetë,

Ne përkrahim Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës për propozimin që të vëhet në rend të ditës çështja e Rezolutës për njohjen e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të luftës heroike që ka bërë populli shqiptar për çlirimin e vet, për arsy

se mendojmë që këto vlera janë duke u nëpërkëmbër, aq më tepër kur Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte projekt i madhor i realizuar në historinë e çlirimtimit tonë kombëtar në Kosovë. Çështja e vënies së Rezolutës në rend dite të seancës parlamentare për njohjen dhe mbrojtjen e vlerave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të luftës çlirimtare përgjithësisht, e kërkuar nga dy grupet parlamentare – PDK dhe AAK është problematizuar pa nevojë dhe po bëhen pengesa të panevojshme për shkak se nuk është aprovuar në Kryesinë e Parlamentit, pa të drejtë. Nuk ka patur pengesa procedurale dhe kjo madje ka qenë dashur të bëhet edhe më herët, por së paku, tani kur këto vlera, siç thash, po sulmohen, po denigrohen, po nëpërkëmbënen. Prandaj, është e domosdoshme një rezolutë e tillë dhe aq më tepër kur ky Kuvend, me këtë Rezolutë, do të mbronte edhe veten sepse, falë luftës historike të Ushtrisë Çlirimtare të lavdishme të Kosovës, ne sot kemi Kuvendin ku lirshëm mund të punojmë në të mirë të popullit. Nxjerrja në ditën e sotme të një Rezolute të tillë do të kishte edhe një simbolikë nga se do të ishte bërë në përvjetorin e rënies së kryetritit legjendar Adem Jasharit dhe Jasharëve të tjerë heroik. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Dragisha Kërstoviq, shef i Grupit Parlamentar “Kthimi”.

DRAGIŠA KRSTOVIĆ:

Gospodine predsedniče, gospodine predsedniče Vlade, gospodo ministri, dame i gospodo poslanici,

Ja ëu da ponovim ono što sam mnogo puta ponavljao na ovoj govornici. Mislim da ova Skupština, zaista, nema ovlašćenja da usvaja ovakve vrste rezolucija ili deklaracija ni po Ustavnom okviru ni po Rezoluciji 1244. Ja ovaj Parlament podsećam i ovom prilikom da to ne čini i da ne poseže za nečim na šta po ovim dokumentima nema pravo.

Predsedništvo Skupštine, želim da podsetim na odredbu Pravila 19. Poslovnika o radu ove Skupštine, prema kojoj odredbi se na način na koji je u toj odredbi propisano, utvrđuje dnevni red. Dnevni red se utvrđuje tako što se o dnevnom redu odlučuje na Predsedništvo ali se o tome konsultuju i poslaničke grupe odnosno šefovi poslaničkih grupa. Nažalost, ja nisam imao priliku nijednom da budem konsultovan u utvrđivanju odnosno o utvrđivanju predloga dnevnoga reda, pa to nisam imao prilike ni sada.

Pitanje koje se pokreće od poslanika, koji su maločas govorili, po mom dubokom uverenju, nisu hitna pitanja i u svakom slučaju danas, dakle ni u kom slučaju danas ne bi mogla da dodati na dnevni red.

A ako je već u pitanju neka vekovna borba jednog dela gradjana odnosno jednog naroda na Kosovu i Metohiji, ja ëu samo da vas podsetim da su rezultati te vekovne borbe izmedju ostalog i egzodus preko 200 hiljada Srbë koji, ni posle četiri godine, ne mogu da se vrate na svoja ognjišta odnosno u svoje domove.

Isto tako, želim da vas podsetim da je i nekoliko hiljada ubijenih i nestalih Srba rezultat te vekovne borbe, da je rezultat te vekovne borbe i nepostojanje slobode kretanja Srpskog naroda koji živi na Kosovu, da su rezultat te vekovne borbe srađena sa zemljom bezbrojna srpska naselja i sela, da je rezultat te borbe porušeno preko stotinu srpskih bogomolja i da je rezultat te borbe ovo što srpski poslanici u Skupštinu Kosova dolaze blindiranim vozilima.

Nije zaista korektno i, najblaže rečeno, nema smisla da se na ovaj način podmeču rezolucije i da se mi već duže vreme bavimo rezolucijama i rezolucionisanjem. Mi bi smo imali neki preči posao da krenemo u pravcu medjusobnog pomirenja, u pravcu medjusobnog zbljižavanja i u pravcu pravljanja nekih boljih uslova za život svih građana na Kosovu.

Mi smo se u ovu Skupštinu vratili posle dužeg odsustva 13. 02. ove godine i evo već četvrti put imamo za redom rezolucije koje, u najmanju ruku, nisu nešto čime treba ova Skupština da se bavi i nisu nešto što bi imalo smisla.

Ja ovo osećam, i cela koalicija «Povratak» oseća, kao provokaciju i poruku srpskoj koaliciji da ponovo izadje iz ovog Parlamenta i da nismo poželjni u ovoj Skupštini.

Ako nam kao predstavnicima Srpskog naroda nema mesta u Skupštini, postavlja se ozbiljno pitanje – da li ima mesta i Srpskom narodu na prostoru Kosova i Metohije.

I na kraju, ako je ova rezolucija, ova druga rezolucija koju predlažu poslanici koji su neposredno ispred mene govorili, nešto što će biti argument za neku Hašku odbranu nekome, onda mislim da to nije pravi način i da to neće biti nešto ni što će služiti za potvrđivanje nekih optužnica niti će služiti kao nešto što će moći da odbrani neke od onoga što je na ovim prostorima u proteklom vremenu činjeno. Hvala vam!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Zoti Hasan Meta, urdhëroni.

HASAN META:

Zoti kryetar, të nderuar deputetë,

Mendoj se disa gjëra që duhet të shتروhen para Kuvendit të Kosovës janë të domosdoshme dhe duhet të shتروhen me procedurë të shpejtë, në mënyrë që ky Kuvend t'i marrë kompetencat çfarë u kanë dhënë zgjedhësit – qytetarët e Kosovës.

Është e paarsyeshme dhe mund të fajësojmë të gjithë vetëveten, dikush më pak e dikush më shumë, që Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe shoqatat e dalura nga ajo nuk kanë vendin e merituar në Kosovë dhe nuk janë marrë parasysh të hyjnë në procedurën e Kuvendit dhe këtu ta kenë vendin meritor e të duhur dhe është kohë e fundit që kjo të bëhet. Pajtohem plotësisht me propozimin e bërë që kjo të hyjë në procedurë të shpejtë.

Nga ana tjetër, kemi edhe një çështje që është fundamente për Kosovën. Është çështja e decentralizimit. Besoj dhe mendoj se pajtoheni me mua që bashkërisht, të gjithë ne këtu, ta shqyrtojmë këtë çështje të decentralizimit për arsyen se kjo po na hyn nëpër dyerë të tjera dhe qytetarët e Kosovës nga Kuvendi kërkojnë që kjo të shtronhet në Kuvend të trajtohet dhe t'i jipet forma e duhur çështjes së decentralizimit. Sepse, me decentralizimin janë duke u fshehur shumë gjëra.

Në anën tjetër, pajtohem plotësisht me propozimin që çështja e bisedimeve Kosovë-Serbi ta marrë platformën e duhur nga Kuvendi dhe ta japim ne këtu mendimin tonë, sepse qytetarët kanë të drejtë ta kërkojnë një gjë të tillë nga ne. Edhe kjo duhet të futet në procedurë urgjente.

Dhe një çështje fundamente, pa të cilën nuk mund të ecim përpara, në asnjë mënyrë – është çështja e pavarësisë së Kosovës - Deklaratës së pavarësisë. Edhe kjo duhet të hyjë në procedurë të shpejtë.

Përveç që mund t'i bëjmë të gjitha të tjerat, natyrisht duhet patjetër ta kemi edhe një projekt tonin për minoritetet, që nuk e kemi bërë. Ka qenë gabim yni. Do ta bëjmë dhe duhet ta bëjmë nëpërmjet komisioneve të Parlamentit e të tjera.

Ju lus që këto t'i keni parasysh, se përndryshe, në asnjë mënyrë nuk mund të ecim përpara ne si Kosovë, si shqëri dhe ne më në fund duhet ta dijmë cili është fati ynë. Kostumin që na ka prerë bashkësia ndërkombëtare, me Rezolutë, me Kornizë, me disa marrëveshje që po bëhen të fshehta e të tjera - nuk na përshtatet më! Ju lutem, të jemi të vetëdijshëm, qytetarët janë të vetëdijshëm për këtë gjë. Duhet të jenë edhe deputetët e Parlamentit të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Një lutje, para se të procedojmë. Ju lutem të diskutojmë për rendin e ditës, e jo për debate. Mos të vijmë në situatë ta ndërprejmë fjalën, që këtë nuk e dëshiroj. E ka fjalën Edita Tahiri, pastaj Ivanoviq.

EDITA TAHIRI:

I nderuar kryesues, të nderuar deputetë,

Mendoj se janë dy çështje shumë të rëndësishme që sot duhet t'i adresojmë. Çështja e parë është çështja e Rezolutës, e cila mendoj se në fakt, si një zhvillim politik tek ne në frymën e arritjes së një koncensusi shumë të rëndësishëm në planin nacional, ka dashur të ndodhë menjëherë në ditën e parë të konstituimit të këtij Parlamenti. Unë mendoj se jemi shumë vonë me këtë Rezolutë por desha t'ju them se kjo Rezolutë duhet t'i shërbejë unititetit tonë kombëtar, para se gjithash; unititetit të institucioneve tona dhe me këtë rast mendoj se, për t'u arritur kjo - ne duhet të ndjekim modelin e vendeve që kanë dalë nga konfliktet e që kanë bërë një rezolutë të pajtimit për historikun e të kaluarës

dhe pikërisht kjo Rezolutë sot do të duhej të ishte e tillë. Çfarë koncepti duhet të kishte? Për mendimin tim, siç kam thënë menjëherë në seancën e parë të Kuvendit të Kosovës, një muaj pas luftës, kam thënë se arritura e sotme është rezultat i shumë faktorëve. Në planin nacional, është rezultat i irrezistencës paqësore të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe i irrezistencës së armatosur të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Por është edhe rezultat i një shekulli të përpjekjeve tona për çlirim. Janë baballarët dhe gjyshërit tanë që janë marrë me lëvizje nacionaldemokrate e lëvizje të tjera, të kaçakëve e të tjera. Dhe, kjo Rezolutë, po ashtu, duhet të përmbajë kontributin e faktorit ndërkombëtar, në krye me SHBA-të e cila ishte në rolin udhëheqës të këtyre proceseve, në bashkëpunim me Bashkimin Evropian dhe NATO-n.

Unë mendoj se këta faktorë duhet të përmblidhen dhe sot duhet ta kryejmë këtë punë dhe është tepër me rëndësi ta lidhim edhe me rastin e Prekazit, i cili vërtetë ishte ngjarje historike që shënoi nismën e luftës së armatosur dhe natyrisht që vlerat tona të luftës, irrezistencës paqësore ne jemi ata që do t'i mbrojmë institucionalisht. Kjo është për të parën.

Sa i përket çështjes së dialogut. Mendoj se po ashtu sot duhet të debatojmë ...**(ndërprerje në ton)**...Ju falemnderit. E shkurt do të jam, pasi që edhe të tjerët kishin rastin. Çështja e dialogut, si duket është urgjente dhe për javën tjetër ka paralajmëruar zoti Shtajner. Janë disa faktorë që ndikojnë në vendimin tonë si Parlament a dëshirojmë apo nuk dëshirojmë dialogun tash. Së pari, për dialog duhet të vendosë ky Parlament, s'paku sa i përket institucioneve të qeverisjes nacionale kosovare. Ne nuk mund të vendosim për Shtajnerin, atë e dijmë, por për ministrat tanë a do të ulen apo jo në bisedime - ne vendosim këtu. E para, nuk përmendet ndërmjetësimi ndërkombëtar. Çka po ndodh? Ne dijmë të gjithë se vetëm kur është inkuadruar SHBA në bisedime - ka patur sukses. Unë pyetem kujt po i pengon apo kujt po i ngutet sot kur SHBA janë të fokusuar plotësisht me çështjen e Irakut.

E dyta, është fakt se ka koncepte dhe përpjekje që Bashkimi Evropian të merr kompetencat në Kosovë ashtu siç po e bën në Maqedoni dhe po bën përpjekje në Bosnë. Ju lutem, në çështjen e Kosovës, situata ndryshon. Populli i Kosovës ka besim të plotë në SHBA-të, kjo është nën një. E dyta, ne mbështesim Bashkimin Evropian, por jo Bashkimin Evropian i cili bëri të njohur kartën kushtetuese të Serbisë-Malit të Zime Kosovën brenda, dhe tani në formë paragjykuese ne të detyrohem i të pranojmë dialogun. Ka edhe tjera argumente të cilat nuk dëshiroj më tutje t'i vazhdoj sepse dua të irespektoj kryesuesin. Ju falemnderit.

(Duartrokositje)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit, Zoti Ivanoviq.

OLIVER IVANOVIĆ:

Poštovane kolege,

Ja sam hteo da stavim samo primedbu. Da smo debatu počeli pre nego što je usvojen dnevni red, ali ako sa uvažavanjem svih onih tema koje su kolege pre mene govorili, sa uvažavanjem njihovih prava da o svim tim temama govore onda kada dodju na dnevni red, ja ču još jedanput sugerisati da se govorи o dnevnom redu i da po Poslovniku o radu, se na to pozivaju pre svega šefovi poslaničkih grupa i da se ne daje prilika za debatu pre nego što je uopšte dnevni red usvojen. Hvala vam!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Zoti Berat Luzha, si shef i Grupit Parlamentar dhe përveç shefave të grupeve parlamentare, tash për tash nuk mund të paraqiten tjerë për diskutim.

BERAT LUZHA:

Të nderuar deputetë,

Ka disa ditë që nëpërmjet shtypit është informuar opinioni se do të mbahen bisedimet me Serbinë, kurse zyrtarisht ne nuk kemi asnjë njoftim. Në këtë drejtim edhe është nënshkruar një dokument për të cilin ne nuk dijmë çfarë dokumenti është, por në të cilin nuk janë të shënuar edhe titujt e atyre personave të cilët kanë nënshkruar. Unë ndaj mendimin e Grupit Parlamentar të PDK-ës i cili këto nënshkrime, sidomos të bartësve të institucioneve, i konsideron si nënshkrime individuale.

Me Serbinë nuk mund të bëhen tash për tash bisedime, për shkak se nuk janë krijuar kushtet. Serbia, para se të filloj bisedimet me Kosovën, duhet të ndriçojë fatin e 3.500 të të zhdukurve; duhet t'i tregojë sipërfaqet e minuara sepse në Kosovë ka me mijëra hektarë të cilat janë të minuara nga forcat serbe, në të cilat gjithnjë ekziston rreziku të ketë viktima. Dhe, në Kosovë dhe jo vetëm në Kosovë, por edhe në Serbi, ka qindra varreza masive të cilat ende janë të pazbuluara.

Prandaj, kërkoj që këtu në këtë Kuvend, sot të debatohet për këtë çështje dhe të merren qëndrime dhe një platformë dhe Kuvendi të dalë dhe njoftojë zyrtarisht për këto gjëra. Ju falemnderit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju falemnderit. Unë deklarova të mbyllura debatet dhe as replika nuk do të ketë. Më lejoni ta shfrytëzoj edhe unë të drejtën dhe të përgjigjem për atë që po bëj.

Unë ju falënderoj për tërë gamën e mendimeve të shprehura paraprakisht. Kryesia gjerësisht ka biseduar për kërkesën e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe në letrën që i është dërguar Kryesisë dhe kryetarit kërkohet të futet sipas procedurës së rregullt në punën parlamentare. Kryesia ka patur këtë qëndrim – në shumicë: nuk është kontestuar përbajtja e kërkesës së Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës; është kontestuar pika e 5-të në Rezolutën e paraqitur, sepse është e vonshme. Kryesia e Parlamentit, në një mbledhje shumë muaj më parë, ka vendosur njëzërit, që është shumë pozitive, që Komisioni parlamentar për çështje legislative-kushtetuese dhe Qeveria të përgatisin një ligj, i cili në mënyrë ligjore do ta obligonte sjelljen e institucioneve të Kosovës për të gjitha çështjet që ngriten me kërkesën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe janë çështje që janë ngritur nga të gjithë qytetarët e Kosovës.

U bënë 3 vite e më tepër pas çlirimt që institucionet nuk kanë arritur, as ato të Qeverisë së përkohshme as këto të sotit, të bëjnë asgjë substanciale dhe të rëndësishme për të vlerësuar drejt jetërat e dhëna për çlirimin e Kosovës; për ta ndihmuar ekzistencën e familjeve të heronje; të të vrarëve; të martirëve dhe atyre që 10-12 vite me radhë sakrifikuani vetëveten dhe jetën e familjes.

Prandaj, mendoj që ky Parlament duhet të nxjerrë ligj, sepse prej rezolutave dhe deklaratave pak dobi kanë qytetarët e Kosovës. Nuk them se janë të parëndësishme nga domethënia e vlerave politike, por rezultatet pragmatike janë tejet-tejet të ulëta dhe po ju them njëzërit – Kryesia ka vendosur që të veprohet. Pse nuk i është dhënë fare popullaritet as në media as në institucione, është çështje tjetër. Kryesia, gjithmonë i ka sinjalët e disponimit në Parlament dhe në elektorat dhe është munduar, një vit e më tepër, që të krijojë një unitet vepruar në interes të qytetarëve të Kosovës. Dhe unë, pa lejen e Parlamentit, disa herë kam deklaruuar, edhe pse si individ, por kuptohet edhe si ushtrues i një prej funksioneve, për vlerësimet që ka Kosova edhe për luftën, edhe për sakrificat por edhe për të gjitha kontributet që janë dhënë në kontinuitet dhe kryetari i Parlamentit, Kryesia dhe shumica absolute, jam i bindur në Parlament të të gjithëve, nuk është për diskontinuitet të luftës, të tendencave për liri, për pavarësi, për demokraci e tjera. Por ne po mundohemi që ta kanalizojmë institucionalisht dhe po ju them nuk ka qytetar i Kosovës, në veçanti shqiptar, që ditën e sotit nuk e ndien si ditë të dhembjes dhe krenarisë së madhe, sepse ka filluar një epokë shumë e rëndësishme për popullin e Kosovës dhe në veçanti për shqiptarët me vrasjen e komandanit dhe sakrificën e tërë një familjeje. Prandaj, tendencat jo të një grupi të them, por individuale, që me çdo kusht të vijnë në konfrontim mendimesh në Parlament, nuk i kontribuojnë këtyre çështjeve. Sipas asnjë norme të rregullit, sot nuk mund të nxjerim rezolutë, sipas rregullores dhe i kemi vazhdimisht interpretimet që i marrim me shkrim prej atyre që janë të obliguar me interpretuar. Në qoftë se do të futej në procedurë të rregullt, do të duhej prap të vijmë dhe të konfrontohemi këtu me votim kush është sepse nuk është çështje urgjente dhe pse të konfrontohemi për çështjet të cilat ndoshta një shumicë absolute në Parlament – 95% mendojnë njësoi. Prandaj, unë mendoj se Kryesia ka bërë

rendin e ditës, pjesa tjetër për biseda e ato tjera, është çështje tjetër. Ne duhet të procedojmë e të votojmë për rendin e ditës. Urdhëroni zoti Bujar.

BUJAR DUGOLLI:

Zoti kryetar, ju prap nuk më dhatë përgjigje pse keni shkelur procedurën dhe nuk konsultoni shefat e grupeve për rend të ditës. Sa i përket kësaj çështjeje, ju prap keni bërë një shkelje. Nuk është e thënë që çdo propozim të një grupi parlamentar të pajtohen të gjitha grupet, por është shkelje e procedurës në rast se nuk njoftohen deputetët se çka përbanë, çfarë është ai tekst. Unë pajtohem me zonjën Tahiri që tha se duhet të bëhen të gjitha përpjekjet. Por këta deputetë as që kanë parë këtë tekst dhe ju i mbani të bllokuara sirtaret tuaja dhe nuk njoftoni veprimtarinë e grupeve parlamentare. Nuk tentojmë t'ua imponojmë një propozim tonin, por tentojmë që ta fusim në rend dite dhe të përcaktohami a do të shkojmë me rezolutë a do ta rregullojmë këtë çështje me ligj pa pasë nevojë të bëjmë rezolutë. Kështu që, ai ligj, që keni paralajmëruar ju, nuk ka këto kondita që kërkohen për luftën çlirimtare të popullit të Kosovës.

Dhe, thjeshtë, unë nuk mund të pajtohem që para kamerave të folni në këtë mënyrë, ndërsa kur vjen në pyetje blokimi i iniciativave demokratike, të blokohen në këso forme. Unë do të dëshiroja që Kryesia e Kuvendit, edhe pas shkuarjes së zotit Hamiti, të jetë më aktive, por mund të flas që deri tanë të gjitha iniciativat demokratike janë blokuar nga Kryesia me arsyetime banale. Nuk jeni duke rrespektuar Rregulloren dhe pikën 19, që thash, të Rregullores së punës të Kuvendit dhe pikat 3 e 4 - flasin se ju nuk jeni konsultuar as për këtë rend të ditës, e edhe pikat tjera janë kontestuese. Pra, nuk jeni konsultuar me shefat e grupeve dhe mendoj se nuk mund të vazhdohet kështu por duhet të bëhet pauzë, të harmonizohen qëndrimet dhe të vazhdohet më tej. Përndryshe, qëndrimin e Grupit tonë e thash më herët. Ju falemnderit!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Tash për tash s'ju jap të drejtë të bëni asnjë vërejtje. Ju lutem do ta vëmë në votim. Është propozimi që me procedurë urgjente të radhitet në rend të ditës propozimi i Aleancës.

Kush është për propozimin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, le të ngrisë dorën.

Ju lutem po flasim për Rezolutën e propozuar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës!

(Bëhet polemika prej vendit, nuk dëgjohet qartë)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Për të tretën herë po them, vë në votim propozimin e Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Kush është për? Le të numërohen votat ju lutem.

Konstatoj se vetëm 19 deputetë kanë votuar për, prandaj nuk radhitet në rend të ditës.

Ju lutem po vazhdojmë me rendin e ditës. Apo, edhe këtë po e vë në votim:

Kush është për rendin e ditës që keni marrë sot?

61 deputetë kanë votuar për rendin e ditës, prandaj do të punojmë me këtë rend të ditës.

Më parë ia jap fjalën kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, për shkak të rrespektit si lider i një partie. Urdhëroni zotin Thaqi.

HASHIM THAQI:

Duke ju falënderuar për fjalën dhe për mundësinë që të shprehemi para jush, deputetë të nderuar, besoj se s'paku mikrofoni nuk do të shkyçet kësaj radhe. Mirëpo i nderuari kryetar, mendoj se nuk është duke u rrespektuar parimi kryesor i funksionimit të Parlamentit të një vendi, thjeshtë e drejta e fjalës para mikrofonit për t'iu drejtuar njerëzve dhe për të shqyrtuar të gjitha ato çështje që ne mendojmë dhe vlerësojmë se janë të domosdoshme për t'u diskutuar dhe aprovuar nga Parlamenti i Kosovës.

Mendoj se s'është në rregull po qe se mendojmë që mund të ecim përpara duke pretenduar që t'i quesim njerëzit para aktit të kryer me gjëra të panevojshme apo me propozime krejt të panevojshme, të paqëlluara dhe të papranueshme duke shfrytëzuar të udhëhequr e seancës së Parlamentit. Askush në botë nuk ka të drejtë dhe nuk mund ta imponojë deklarimin se gjoja deputetët këtu apo disa deputetë këtu, siç tash u prezentua, gjoja deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës dhe deputetët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, të LPK-ës, të Partisë së Drejtësisë, të LKÇK-ës janë kundër luftës, janë kundër ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, nuk e votojnë rezolutën për njobjen e luftës. Ky është absurd! Janë kundër vetëvetës?! Janë kundër asaj që kanë udhëhequr vetë! Janë kundër rezistencës më heroike të popullit të Kosovës! Kundër Komandantit Legjendar Adem Jashari! Ky është absurd! Ju lutem, nuk mund t'na qitni në pozicione të tilla.

Zoti Daci, megjithë rrespektin, ne kemi diskutuar gjatë për këtë çështje dhe nuk është kjo Rezolutë e Aleancës. Është Rezolutë e të gjitha partive, mendoj. Sepse as të LDK-ës, që nuk votuan, jam i bindur nuk janë kundër UÇK-ës. Besoj dhe jam i bindur, as kundër Komandantit Legjendar Adem Jasharit. Pse hezitojmë të diskutojmë këtë çështje

apo ta aprovojmë këtu. Besoj, as minoritarët. Pse të mos e njohim luftën, sakrificën tonë që kemi zhvilluar? Pse të mos e legalizojmë këtë çështje botërisht para botës? Çka na pengon kjo? Kë e pengon kjo? Pse na pengon? Mendoj se nuk është në rregull. Njerëzit presin nga ne. E kemi votën e elektoratit. Prandaj duhet të veprojmë në mënyrë unike.

Nuk pajtohem me atë që të fusim divergjenca tash në mes PDK-ës, AAK-ës në njëren anë dhe LDK-ës në anën tjeter. Mendoj se kjo është e rrezikshme për procesin. Ne kemi institucionë të dalura nga nënshkrimet e tre liderëve politikë: nga zoti Rugova, nga zoti Haradinaj, por edhe nga unë, si lider i Partisë Demokratike të Kosovës. Unë mbështes plotësisht atë marrëveshje dhe e mbështesin edhe liderët tuaj, edhe zoti Rugova, edhe zoti Haradinaj, që mungon sot këtu. Por nuk është në rregull të qitet diçka për të votuar, një propozim të Grupit Parlamentar që sot mungon këtu. Nuk është mirë që të qitet në votimin e Parlamentit të Kosovës dhe tash të kontestohet thjeshtë gjaku i 1.700 dëshmorëve të lirisë; i 700 invalidëve të luftës; i të gjithë atyre fëmijëve jetimë. Të kontestohet sakifica e popullit të Kosovës. Askush nuk konteston periudhën 90-97-98. Ne kemi ardhur deri këtu bashkërisht dhe ata liderë, ata bartës të institucioneve të rrezistencës 90-98-99-2000 kanë ditur të sakrifikojnë, të sfidojnë edhe ato situata të rëndë e të jashtëzakonshme dhe jam i bindur se ne do të dijmë të fitojmë bashkërisht edhe paqën, do ta ndërtojmë lirinë e plotë të Kosovës dhe rendin demokratik. Të mos pretendon ndokush se vetëm një parti do ta avancojë procesin e Kosovës. Të mos pretendon ndokush se një parti në dém të tjetrës do të ndërtojë perspektivë e në veçanti për popullin e Kosovës.

Prandaj, zoti Daci, kërkoj nga ju si kryesues i Parlamentit, fillimi shqiptar siç e keni luajtur një rol konstruktiv edhe më herët, të vazhdoni një rol të tillë të unifikimit të spektrit politik, sepse keni edhe obligime të tillë dhe bashkë me këtë mendoj se në Kryesi kanë ndodhur gjëra jo të mira, sepse krejt ndryshe është folur në opinionin publik krejt ndryshe është diskutuar në Kryesi. Prandaj, do të ishte shumë me rëndësi që ajo çështje që është ngritur nga përfaqësuesit e Aleancës, por që nuk është vetëm e Aleancës por është e të gjithëve, e besoj se është edhe juaja sepse ju folët shumë bukur, por mendoj se do të ishte mirë që edhe të veprohet mirë dhe drejt dhe të mos kontestohet askush për të diskutuar, fillimi shqiptar, për t'i shprehë opinionet e veta e jo t'i myllim tash diskutimet këtu sepse s'ka diskutime. Ne jemi në pluralizëm, në demokraci dhe të gjithë duhet të flasim atë çka mendojmë dhe duhet ta shprehim këtu, bashkërisht me njëri-tjetrin. Nëse është nevoja, edhe kur kemi kundërthënie me njëri-tjetrin dhe është mirë që kemi kukndërthënie. Ne nuk mund të shkruhem i gjithë në një parti. Prandaj edhe nuk mund t'i bindemi të gjithë një lideri që sot udhëheq Parlamentin e Kosovës. Kemi opinionet e ndryshme, duhet t'i shtrojimë këtu, t'i diskutojmë por edhe të nxjerim konkluzion të drejtë për vendin dhe popullin e Kosovës dhe perspektivën e saj.

U hapën edhe disa çështje të tjera këtu. Është nënshkruar deklarata e së premtës. E mbështes plotësisht atë deklaratë, siç e mbështetni sigurisht edhe ju nënshkrimin e liderit tuaj apo të kryeministrat dhe të zotit Daci. Ju mund të keni vërejtje sa i përket çështjeve procedurale të nënshkrimeve, por si do që të jetë ato janë çështje serioze. Nuk kemi nevojë këtu thjeshtë të shkaktojmë shou për arsy se duhet të diskutojmë çështjet seriozisht, t'i shohim cilat janë anët pozitive e cilat negative dhe pastaj të ndërmarrim veprime të duhura, të mençura dhe në përputhje me orientimet tona. Kosova ka një prezencë jashtëzakonisht të madhe, për fat tonin, ndërkombëtare edhe politike, edhe humanitare, edhë ushtarake. Por më vjen keq, vazhdojmë të qëndrojmë vendi më i

izoluar i rajonit. Prandaj, deklarata e nënshkruar nuk është ndonjë marrëveshje, ju të gjithë e dini. Është një deklaratë pajtuese, në parim, për të bashkëpunuar me të gjitha vendet e botës, me të gjitha vendet tjera dhe nuk specifikon asnje vend favorizues për bisedime.

Kisha kërkuar, zoti Daci, edhe një herë që të kalojmë në një pauzë, të diskutojnë grupet parlamentare një herë qetas, urtë e butë dhe të nxjerrin konkluzionin e drejtë për vazhdimin e seancës së sotme, natyrisht duke vazhduar pastaj edhe me rendin e ditës, sepse kemi këtu edhe kryeministrin, i cili paraqet raportin e tij njëvjeçar të punës dhe natyrisht se do të kemi edhe diskutime të frytshme. Në kuadër të kësaj, ju falënderoj për kohën që mora, ndoshta të tepërt, por si do që të jetë, mendoj se është momenti që të diskutohen këto çështje seriozisht në veçanti njohja dhe rrespekti i luftës çlirimtare të Kosovës, rrezistenca e popullit të Kosovës, rrezistenca e të gjithë njerëzve që kanë dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm për të ardhur në këtë ditë Kosova dhe pastaj të vazhdojmë me rendin e ditës.

Por këto janë ditët e Jasharajve, janë ditët e Komendantit Legjendar të Adem Jasharit, këto janë ditët e lirisë së popullit të Kosovës, prandaj kanë edhe simbolikën por edhe domosdoshmérinë e vet që kjo çështje të diskutohet dhe natyrisht të marrë qëndrim të drejtë Parlamenti i Kosovës. Por askush nuk ka të drejtë të konstatojë se një pjesë e grupeve parlamentare janë kundër asaj rezolute, ndërsa të tjerët janë që të vazhdohet me rendin e ditës. Nuk mund të janë kundër luftës dhe Komendantit Legjendar së paku njerëzit e PDK-ës e as të AAK-ës, zoti Daci, prandaj mendoj se duhet pak më ndryshe të shtrohen çështjet. Ju falemnderit!

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Ju lutem, është e arritura më e madhe e Kuvendit të Kosovës që në ditën e konstituimit kemi pasur pikëpamje diametralisht të kundërtë me zotin Thaqi e sot i kemi për 90-95% çështjet kruçiale të njëjta. Unë dua t'ju informoj: kryetari i Parlamentit, kurrë, në asnje rast nuk ka qëndrime të ndryshme. Varet se si është informuar dhe si informohet lideri i PD të Kosovës. Një qëndrim kam patur në Kryesi, një qëndrim kam në Parlament. Për ta ruajtur unitetin veprues 2-3 herë grupet tjera parlamentare, në një mënyrë, me pauza jemi munduar që ta mbulojmë unitetin veprues për t'i përkrahur. Fare nuk janë konsultuar asnje grup tjeter parlamentar dhe kjo ka qenë brengosja kryesore e kryetarit të Parlamentit dhe e krejt Parlamentit. Dhe nuk duhet në të ardhmen, për çështje kaq të rëndësishme, të testohet me çdo kusht që grupi fitues i zgjedhjeve, grupi më i madh parlamentar të vendoset në anën tjeter të historisë ose të barikadave. Kjo nuk mund të ngajajë, derisa, më lejoni, ta udhëheq unë Parlamentin dhe përgjegjësitë bashkërisht me ju ose individuale i marr gjithmonë.

Prandaj, do të ketë pauzë dhe po ju them edhe njëherë, çka kam thënë edhe në Kryesi – nënshkrimi i marrëveshjes së njëvjetorit, deklaratën që kemi bërë, unë kam thënë qëndroj në Kryesi, Kryesia as që është kompetente të diskutojë për atë. Ka qenë e tërë marrëveshja ose deklarata në mjete publike dhe në qoftë se ndonjë deputet ka patur vërejtje në atë ka mund me shkrim t'ia bëjë edhe Parlamentit edhe partive politike. Asnjë nuk ka bërë atë. Një deklaratë e përgjithësuar dhe më vjen mirë që zoti Thaqi u deklarua, prandaj unë qëndroj prapa nënshkrimit tim dhe për çdo çështje tjeter mund të bisedohet, e për çështjen e Rezolutës sot nuk është në rend të ditës. Tash do ta kemi një

pauzë dhe lus shefat e grupeve parlamentare dhe Kryesinë dhe të shohim si do t'ia bëjmë. Ju falemnderit.

(Vijon pauza)

(Pas pauzës, seanca vazhdoi punën)

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Të nderuar deputetë, po vazhdojmë punën.

...Gjatë pauzës u takuam me grupet parlamentare dhe me konsensus kemi vendosur sa vijon:

Edhe përkah gatishmërisë së kryeministrit dhe pranisë së tij që ta kryej detyrën dhe t'i raportojë Kuvendit për punën njëvjeçare, të kabinetit të tij dhe të Qeverisë, teknikisht nuk janë plotësuar kriteret që të mund të përkthehet dhe të shpërndahet, për këtë arsy nuk mund të kemi një paraqitje të fjalës hyrëse të kryeministrit e pastaj të zhvillohet edhe debati konstruktiv, propozjmë që seanca në tërësi edhe për shqyrtimin e ligjit dhe çështjeve tjera, sipas rendit të ditës së aprovuar, të shtyhet për javën e ardhshme.

Ju falemnderit, shihemi - sot një javë.

(Puna e seancës, do të vazhdohet të enjten e ardhshme)